

Prof. dr. Ramazan H. BOGDANI

KUMTIME ETNOFOLKLORIKE DHE ETNOLOGJIKE

Në këtë studim përfshihen dy artikuj nga fusha e *etnokoreologjisë shqiptare* (folkloristike) dhe një nga *etnologjia*. Secili nga artikujt ka mëvetësinë për sa i përket problematikës. Kësodore, *i pari* shqyrton tipare të një karakteri teorik nga vallëzimi popullor. *I dyti*, përmes një makrovalleje, rrok koreografinë popullore kosovare. Kurse *i treti*, nga një ndërthurje e dyanshme etnofolklorike dhe etnologjike (sigurisht që në të shtjellohet edhe vallëzimi arbëresh), na shpie ne botën arbëreshe të Italisë.

Në pamje më të përgjithshme, të veçantat e këtyre artikujve dëshmojnë karakterin e etnisë mbarëkombëtare në fushën e kulturës popullore.

1. Dy dimensione të etnokoreologjisë shqiptare (*Improvizimi dhe individualiteti*)

Improvizimi në vallëzimin popullor në rrafsh krijues

Karakter i improvizues është një nga tiparet më të qenësishme të vallëzimit popullor shqiptar, që në një konceptim të përgjithshëm shfaqet më së shumti në *vallet humoristike dhe vallet pantomimike*. Shtjellimi i fabulës në këto njësi, veç bërthamës së përhershme, pasurohet edhe me spontanitetin e lojës së valltarëve popullorë. Kjo është arsyeja që plastika e kërcimit nuk është krejtësisht e përcaktuar, por në varësi të aftësive interpretuese të valltarëve dhe gjithmonë brenda shtratit të fondit koreografik krahinor.

Në vallet humoristike, ndofta ndryshe nga llojet e tjera të lirikës koreografike, ka të tilla që *lidhen me një emër të caktuar*, i cili ka dhënë drejtpërdrejt ndihmesën për lindjen, kristalizimin dhe përhapjen e valles. Pra, njësi të kësaj natyre kanë pasur një fillësë

krijuese individuale që, dalëngadalë, nga përhapja e veçantë ideo-emocionale, thjeshtësia kompozicionale dhe forca e madhe komunikuese, kanë ftuar në kërcim edhe valltarë të tjerë, çka i ka dhënë valles fillestare tiparet e krijimeve kolektive.

Për ilustrim të rolit krijues të interpretuesve lidhur me improvizimin po sjellim një njësi vetjake burrash, “*Vallen e Xhaferr Kabës*”.

Ajo është krijuar nga një njeri (Xhaferr Kaba) dhe, si e tillë, në radhë të parë i përket kryesisht një fshati apo zone të caktuar, por nga përmbajtja e veçantë humoristike dhe popullarizimi që gëzon, ajo, si çdo njësi folklorike, e ka humbur pothuajse autorësinë, duke u bërë një krijim popullor me shtrirje të gjerë. “*Vallja e Xhaferr Kabës*” është krijuar në rrethana të caktuara. Deri në fillim të shekullit të kaluar, kur u plagos në këmbë, Xhaferr Kaba, prej të cilit mori emrin vallja, njihej si këngëtar dhe valltar i shquar, ai i binte mirë edhe çiftelisë. Më pas, ndonëse artikulimi i gjurit të këmbës së djathtë nuk i lëvizte, nga dëshira e madhe për të kërcyer, ai ngrihej në valle edhe ashtu i gjymtuar. Natyrisht, kërcimi i tij ndryshonte nga i të tjerëve: në një anë binte në sy përpjekja për të luajtur sa më hijshëm, si njëherë e një kohë, dhe, nga ana tjetër, pamundësia e Xhaferrit për të vallëzuar si më parë. Lindi kështu vetvetiu, si të thuash, një krijim i ri folklorik. Xhaferrri kërcen i mbështetur në shkop dhe një i dytë e mban për dore, ndërkohë që instrumentistët ekzekutojnë një melodi që e përshtatën nga vallet e grave për vallëzimin e tij. Valltari përpqej të luante një kërcim vendas të rëndë që, vetvetiu, i ekzekutuar prej tij, merrte edhe ngjyime humoristike.

Improvizimi, si një dukuri e rëndësishme në varietetin dhe larminë e kërcimeve, duket edhe nga të *pranishmit përreth* gjatë ekzekutimit të valleve. Kështu, veçanërisht gjatë valleve *humoristike dhe pantomimike*, mjedisi reagon jo me përqeshje të hidhura, por me të qeshurën e përmbajtur, jo me gazin e trishtuar, por me humorin e shëndetshëm, që përbën dominanten estetike të valleve të interpretuara. Funkzioni i të pranishmëve përreth është i madh edhe gjatë *luajtjes së valleve në ceremonialin e dasmës*.

Gjithë periudha e dasmës përcillet me këngë e valle duke i përngjarë kështu një spektakli popullor. Në vallet pantonimike mjedisi përreth ndërhyt edhe me mizanskena dhe gjestikulacione

plastiko-koreografike të natyrës së *dramaturgjisë popullore*. Te riti i *gjamës tradicionale*, si dhe në të tilla të tjera, qofshin këto *magjike* apo me *elemente religjioze* (fetare), mjedisi operon edhe me njësi nga fusha e *folklorit dramatik*. Në ndonjë *valle me karakter luftarak*, të pranishmit përreth ndërhyjnë për paqësimin e situatës, duke luajtur kështu rol të rëndësishëm në shtjellimin e fabulës. Ndërsa në *vallet kaçakçe* (trimërishte), mjedisi është më afër interpretuesve, duke vepruar me elemente pantomimike dhe teatralo-romantike që i përshkon ato lloj vallesh.

Në hapësirën e improvizimit, luajnë rol *dallimet dhe përbashkësitë midis valles folklorike në mjediset intime dhe asaj në manifestimet popullore*.

Dihet tashmë se ka ndryshim mes valles që praktikohet spontanisht në familje, në dasmë, në bjeshkë e gjetkë, ku interpretuesit janë krejtësisht të lirë, dhe valles folklorike në skenë, që, vetvetiu, ajo u nënshtrohet disa kritereve të veçanta. Lidhur me të dytën, do të theksonim se në manifestimet popullore, siç janë *festivalet folklorike*, me sukses po shfaqet procesi i përtëritjes së disa valleve tradicionale të interpretuara nga *artistët e vegjël*. Tradita e vallëzimit tonë popullor nuk ka pothuajse valle të mirëfillta enkas për fëmijë, (pa mohuar këtu, sigurisht, elementet apo kërcimet specifike gjatë ritualeve të ndryshme tradicionale). Pikërisht, nëpërmjet festivaleve folklorike kjo zbrazëti po mbushet në njëfarë mase. Krijime të tilla janë karakterizuar për freskinë e tyre, pa imitime të valleve të të rriturve. Ato janë konceptuar drejt, duke iu përshtatur moshës, shkallës së zhvillimit psikik dhe mundësive interpretuese të fëmijëve. Nëpërmjet tyre kryhet më së miri transmetimi i traditave popullore nga njëri brez tek tjetri. Në qerthullin e krijimeve të fëmijëve spikasin veçanërisht ritualet e ringjalljes së natyrës, të cilat, me mjete kërcyese e lodruese, përshkojnë fabulat e disa valleve të gërshetuara me elemente mizanskeniko-koreografike: *mbledhja e luleve, kapërcimet e zjarreve* etj.

Po kështu, edhe *vallet-lojë* kanë nisur të gjallërohen nëpërmjet paraqitjes së tyre në festivale të ndryshme. Kështu, veçanërisht vallet që imitojnë kafshët, shpendët, insektet etj., të shtratit tradicional, por pothuajse të harruar, me notat gazmore dhe humorin e gjallë që i përshkon, ashtu edhe me konceptimin artistik, janë ndjekur me kërshtëri të madhe.

Individualiteti në vallëzimin popullor në rrafsh ekzekutues

Në vallëzimin popullor shqiptar, veç fenomenit të improvizimit në aspektin krijues, ka rol edhe individualiteti i valltarëve në rrafsh ekzekutues. Individualiteti i mjeteve shprehëse koreografike është në vartësi të përmbajtjes ideoemocionale të valles. Por, brishtësia apo vrullëzimi i lëvizjeve, thjeshtësia apo dinamika e figurave dhe, përgjithësisht, intonacionet koreografike, janë të kushtëzuara nga gjendja shpirtërore psikologjike e bartësve ekzekutues. Veçanërisht, kërcimet vetjake kërkojnë interpretues të zot, që të jenë njëherësh valltarë, por edhe këngëtarë, kur vallja është e kënduar. Lirizmi dhe eleganca, apo gjallëria dhe zhdërvjelltësia përbëjnë tiparet më të qenësishme të këtij lloji individualiteti ekzekutues. Këto dukuri, në vështrim dyplanësh, rastis të ndërthuren brenda një valleje. Kështu, në një kërcim të zonës së Tropojës (Shqipëria e Veriut), njëra nga gratë valltare e nis kërcimin me një plastikë koreografike të qetë, të përmbajtur dhe tepër shprehëse. Spikat harmonizimi estetik i lëvizjeve, qëndrimi monumental i trupit, valëvitjet e lehta të tij, vështrimi i mprehtë dhe fiksimi i duarve. Përftohet një atmosferë e theksuar lirike ku mishërohet bota e brendshme e ekzekutueses. Gruaja e dytë, që vijon kërcimin, luan më shpejt, me kërcyeshmëri më të zhvilluar, me dinamikë entuziaste e optimiste. Ecjet e imëta brinjas dhe rrotullimet e vrullëzuara, janë njëherësh veti të individualitetit të valltares ekzekutuese.

Po kaq i dukshëm është individualiteti ekzekutues edhe në vallet masive. Pa shkëputur vëmendjen nga dy variantet e mësipërme të valles së grave të Tropojës, në vijim të saj rastis që të futen në kërcim disa valltare, duke e luajtur atë me shumë veta. Për nga interpretimi dhe ndërtimi arkitektonik, vallja në këtë rast ruan mirëfilli klimën origjinale të kërcimeve tradicionale vendase. Me këtë kemi parasysh lojën pa u harmonizuar në formacione të rregullta koreografike, Vajzat, edhe pse në grup, ekzekutojnë në mënyrë të lirë vetjake. Fillimisht kërcimi duket i painedividualizuar, i papërcaktuar koreografikisht. Por pikërisht këtu qëndron ajo veçanti, që e bën atë nga kërcimet më të kristalizuara e më të shquara të traditës vendase: në momente të caktuara të ekzekutimit vërehet edhe bashkëveprimi i lëvizjeve

nga të gjitha valltaret. Pra, shtjellimi koreografik realizohet në dy plane, alternimi i të cilave brenda një valleje ia rrit asaj vlerat artistiko-estetike. Veçori dalluese është se ekzekutueset komunikojnë njëra me tjetrën me vështrime dhe harmonizimin e pjesshëm të kërcimeve. Gjatë lojës, lëvizjet dhe motivet nuk kanë radhë: ato shtjellohen organikisht, në mënyrë intuitive, në përshtatje me vetë individualitetin e valltareve ekzekutuese. Kontrastet e shumanshme koreografike, të cilat krijohen nga kërcimi i ndryshëm e, njëkohësisht, i njëhershëm i dy-tri grupeve të valltareve, i japin valles atë originalitet etnokulturor shqiptar, që e hasim në shumë krahina veriore të Shqipërisë me nuancime të larmishme. Kjo ishte edhe arsyeja që zgjodhëm si tipike për individualitetin në rrafsh ekzekutimi pikërisht këtë lloj valleje.

Individualiteti në vallëzimin popullor shqiptar në rrafsh ekzekutues duket më së miri edhe në disa *valle të veçanta* që mbajnë vulën e drejtpërdrejtë të krijuesve dhe interpretuesve të shquar të tyre. Të tilla ka me dhjetëra e dhjetëra në traditën e vallëzimit shqiptar. Ashtu si në të gjitha emërtimet e shumta, edhe në rastin e qenësishëm të valleve me emra të veçantë, shfaqen prirjet, aftësitë dhe vetitë krijuese e ekzekutuese të disa njerëzve të shquar. Në këtë rast, çdo emërtim vallesh shpreh një përmbajtje edeoemocionale të caktuar, një ngjarje, një ndodhi, rrethana të veçanta historiko-shoqërore. Ai përbën një relikë folklorike, por njëherësh dhe kyç nga nisemi për studimin e etimologjisë së valles, për origjinën dhe jetën e saj artistike në planin ekzekutues dhe më gjerë. Këto krijime, duke marrë jetë nga zemra dhe shpirti i vetë ekzekutuesve, bartësve popullorë, jetojnë sot të gjalla dhe praktikohen gjerësisht në veprimtaritë praktike. Dhe, në hapësirën e emërtimeve të përgjithshme, ato përbëjnë një fond me vlera të jashtëzakonshme për shkencën e etnokoreografike shqiptare dhe për mbarë kulturën tonë popullore.

Këto ishin shkurtimisht dy nga dimensionet e shumta dhe të pasura të koreografisë popullore shqiptare.

2. Tradita dhe evoluimi në makrovallen “Shota” të Kosovës

Tradita etnokoreografike shqiptare përfshin qindra e qindra

valle, ndër to edhe të tilla me përmasa gjithëpërfshirëse, për nga origjina, fizionomia dhe vlerat artistike e shkencore. Të dytat janë të quajturat *makrovalle* dhe njëra është e skalitur me emrin "*Vallja e Shotës*" apo "*Kcimi i Shotës*", siç quhet ndryshe.

Nisur nga një vlerësim i lartë, autori i këtij artikulli, ndërmjet të tjerash, e ka gjurmuar këtë krijim duke qenë i pranishëm në veprimtari, të tilla si: Ekspeditë Folklorike në Rrafshin e Dukagjinit të Kosovës (1972); Ekspeditë Folklorike në Rugovë dhe Opojë të Kosovës (1979); Festivali Burimor i Këngëve dhe Valleve Kosovare (Glllogovc, 1980); Ekspeditë Folklorike në Has të Kosovës (2001); Revista e Folklorit Burimor Shqiptar (Drenasi – Kosovë, 2002); Festivali Folklorik "Hasi jehon – 2003" (Gjonaj, 2003). Gjithashtu, këtë valle e kemi ndjekur për një periudhë 40-vjeçare përmes SHKA të Kosovës që kanë dhënë koncerte në Shqipëri, Maqedoni dhe gjetkë.

Nga këto gjurmime të autorit rezultojnë disa variante të filmuara të "*Valles së Shotës*", të cilat ruhen në Arkivin e Institutit të Kulturës Popullore (Kinofilmoteka, Videoteka dhe Fotofilmoteka) pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Disa konsiderata për traditën e valles "Kcimi i Shotës"

Si rrjedhojë e gjurmimeve në terrenin kosovar, është ndër vallet më të njohura e të popullarizuara te shqiptarët e Rrafshit të Dukagjinit dhe të mbarë Kosovës (ekzekutohet në fshat e qytet, nga burra e gra).

Kjo valle ka lindur afër mesit të shekullit të kaluar. Emrin e ka marrë nga fjala *shotë* (një lloj rose e madhe), që në përgjithësi përdoret me përkëdheli po ashtu dhe për vajzat e reja, të shkathëta e të pashme. Në këngën që shoqëron vallen, gjejmë vargjet: "*Hajde, shot-o, mashalla, / Fluturo me krah*" etj. Ndonëse përcjellja muzikore kombinohet herë vetëm me instrumente e herë me instrumente e këngë.

Nga mënyra e të ekzekutuarit, vallja paraqitet në disa variante. Por ai *djalë-vajzë* (mashkull-femër) e karakterizon atë krijim me përmbajtje të theksuar lirike dhe, në një masë të konsiderueshme, përshkohet edhe nga *elemente erotike*. Luhet në të gjitha tubimet festive dhe më shumë gjatë ceremonialit të dasmës, si një njësi me shumë dritë, me veçori zbukurimore dhe intensitet të

larmishëm.

Në mjedisin e të pranishmëve, gjatë ekzekutimit të valles krijohet klima e përshtatshme estetiko-emocionale për një interpretim original e krijues, në përshtatje me përmbajtjen *liriko-erotike* të saj. Kërcimi ka atmosferë festivo-optimiste. Luhet me finesë dhe elegancë, por edhe me zhdërvjelltësi e ekspresivitet. Pra, mbizotërojnë dy plane kontrastuese që i japin atij krijimi një fizionomi imponante, monumentale. Valltarët interpretues kërcëjnë bashkërisht dhe, ndonëse të shkëputur nga njëri-tjetri, motivet dhe figurat plastike i harmonizojnë estetikisht.

Në lojën e valles spikat komunikimi, lidhja midis djalit dhe vajzës, e cila kryhet jo vetëm nëpërmjet vështrimeve, por edhe përmes tërësisë së një bote të brendshme të pasur që pasqyrohet me mjete të larmishme koreografike dhe një interpretim mjeshtëror. Pikërisht në atmosferën e përgjithshme të kërcimit dhe në shpërthimet e brendshme të valltarëve interpretues del në pah *erotika e valles*.

Nga pikëpamja e stilit ndërthuret mënyra grarishte dhe ajo burrërishte e të vallëzuarit. E para duket kryesisht te vajza dhe pjesërisht te djali, kurse kërcimi burrërisht përfaqësohet nga djali, tek i cili gjallësia e lëvizjeve, në një masë të konsiderueshme, kushtëzohet edhe nga shoqërimi muzikor, më së shumti kur vallja kërcëhet me curle e lodër, përcjellje kjo e qenësishme që haset gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit.

Kjo do të ishte me pak fjalë kuintesenca e përmbajtjes liriko-erotike të kësaj makrovalleje.

Rreth një varianti evolutiv të "Valles së Shotës"

Në shkrimin për këtë problem do të kemi objekt një variant që na bëri jo vetëm ta pranojmë, por të mirëqenë për nga hopi dhe ligjimiteti artistik e shkencor. Është fjala për vallen "*Shota*" - *humoristike* e një dyshe valltarësh të SHKA "*Lahuta e Malësisë*" - Gjilan, e cila u luajt në Revistën e Folklorit Burimor Shqiptar - Drenasi - Kosovë, 2002.

Ishte befasi e madhe që kjo valle u paraqit si një krijim humoristik, me një konceptim dhe realizim të mahnitshëm që e bënë, të paktën për autorin e këtij artikulli, njërën nga perlat e asaj reviste.

"Shota"- *humoristike*, mbi bazën e valles tradicionale të një lirike erotike, është konceptuar si një *parodizim koreografik*, brenda suazës folklorike. Vallja luhet nga dy vetë, një djalë dhe një vajzë. Djali përfaqëson personazhin kryesor, të riun që magjepset nga bukuria e vajzës, "Shotës". Përmes fjalëve që djali i drejton jo vetëm partneres, ai komunikon edhe me spektatorët. Në momente të caktuara pas dialogimeve të tilla, djali i drejtohet me emër curlexhiut, për shembull: "Ç'pret! Bjeri asaj curleje sa t'buçasi!". E rëndësishme është se dialogime të tilla alternohen natyrshëm sipas rrjedhës së pasazheve të fabulës. Pra, mjetet shprehëse koreografike ndërthuren në këtë valle edhe me dukuri të *folklorit dramatik* (fjala, gjesti, pantomima), duke i dhënë lëvizshmëri plastike. Elementet liriko-erotike, humoristike dhe dramatike sinkretizohen në mënyrë organike, duke shprehur thellësi mendimi në zberthim të idesë së fabulës.

Por përparësia e begatisë së këtij varianti folklorik qëndron kryesisht në *përmbajtjen humoristike*, e cila transmetohet me forcë emocionuese nga loja e valltarëve interpretues.

Nga pikëpamja e ndërtimit morfologjik veprimet organizohen në dy plane kryesore. Në të parin shquajnë pasazhet parodizuese, të një natyre teatrale ku, siç u theksua, gërshetohet edhe fjala, kurse në të dytin ka kryesisht kërcime të mirëfillta, të burimit amë të këtij krijimi.

Gjatë ekzekutimit bie në sy individualiteti krijues i të dy valltarëve. Përfytyra dalluese dhe tipari më i kristalizuar vërehen kryesisht te valltari djalë që udhëheq lojën, e cila karakterizohet nga imitime koreografike - pantomimike të një natyre zbavitëse. Ndërsa valltarja vajzë, shquan vërtet për finesë e elegancë në mjetet shprehëse dhe në interpretimin me atmosferë lirike, por këto realizohen me natyrë shpërthyesë në përshtatje me vetë fabulën e valles. Një veti tjetër e këtij interpretimi është se, për mendimin tonë, figura e gruas kosovare portretizohet edhe psikologjikisht, edhe koreografikisht. Pra, kemi një krijim me përmbajtje ideore, me shumë dritë.

Vallja "Shota"- *humoristike*, edhe ngaqë është konceptuar në një variant të ri, tingëllon e freskët; në të mbizotëron një klimë e përgjithshme humoristike, por edhe bota lirike intime e burimit amë. Duke gërshetuar traditën dhe risinë, interpretuesit e saj

arritën të shfaqnin një krijim me tingëllim sa original, aq edhe bashkëkohor, me vlera estetike të pamohueshme.

Së fundi, tradita dhe evoluimi në makrovallen “*Shota*”, përmes dy versioneve, përkatësisht me përmbajtje *lirike erotike* dhe *lirike humoristike*, bartin një unitet etnokoreografik, duke e kristalizuar *vallëzimin popullor kosovar*, por, rrjedhimisht, edhe *etnokoreologjinë mbarëkombëtare shqiptare*.

3. Ritualet e martesës arbëreshe

(Nga Festivali i Dytë i Muzikës dhe i Valles Arbëreshe)

Festivali i Dytë Evromesdhetar i Muzikës dhe i Valles Arbëreshe (Strighar – Itali, 5-9 gusht 2003), që u organizua nga Qendra e Studimeve dhe Kërkimeve të Traditave Popullore Arbëreshe, me President Italo Elmo, u kurorëzua nga atmosfera festive e komunitetit të arbëreshëve të Italisë. Ai shpalosi vlera të konsiderueshme të folklorit vendës, tradicional dhe bashkëkohor. Në këtë spektër, tematika e *ritualeve të martesës* u paraqit sipas traditës, me fizionomi romantike. Ato qenë të dukshme dhe të prekshme kryesisht nga grupet pjesëmarrëse me *folklor burimor*.

Ritualet e martesës në atë festival u shtjelluan me kahje etnografike sipas disa etapave të caktuara tradicionale. Zhvillimi i tyre përmes ndërthurjeve me këngë e valle sikur krijoi një atmosferë më joshëse dhe emocionale, gjë që ngjalli interes të veçantë. Në këtë hapësirë, brenda caqeve të një artikulli do të bëjmë objekt ritualet e martesës që u trajtuan nga disa grupe arbëreshe.

Përshtypje shumë të mira la “*Vjershëtarët*” nga Shën Sofia, i cili, përmes një përgjithësimi arbëresh të ritualit të martesës, pati edhe grimca dhe nuanca unikale, përfaqësimi, nga fshati i vet. Paraqitja e ritualit të martesës nga ky grup që organizuar në formën e një *kolazhi*. Si në të shumtën e grupeve, edhe në këtë rast pjesëmarrja ishte me gra të moshuara por edhe vajza e djem. Kënga “*E mbrëma e mirë, mirë se ju çomi, / E mbrëma e mirë, mirë se na vini*”, u uronte mirëseardhjen dasmorëve për martesën e çiftit. Nga ky grup ngjalli interes ceremoniali i përgatitjes së “*biljes*” (bijës për nuse), që u shtjellua me ritin arbëresh “*Ngreu nuse, unju nuse*”. Këtu, veç veprimeve mizanskenike, pati përcjellje me këngë nga katër gra.

Njëherësh, një grup grash të tjera në sfondin e skenës merr pjesë herë pas here me këngë në këtë rit të programit. Interesante që edhe veprimi i grave *"rruffjane"*, siç përcaktohen ato që shkojnë derë më derë për të *"lipur dorën e biljes"*.

Po nga *"Vjershëtarët"* e Shën Sofisë bukur u paraqit pasazhi i serenatës, ku dy djem të veshur me pelerina, këndojnë në formë akapelo poshtë dritares së çiftit të porsamartuar këngën *"Vashëz e bukur pjot me erë"*. Ngjalli kërshtëri çasti kur çifti i të porsamartuarve u ul nga dritarja me litarë këngëtarëve një shportë me verë dhe ushqime.

Nga disa grupe me folklor burimor pati interes të madh riti *"Çami kulaçin"*, që zhvillohet në ditët e para të pasmartesës. Ky rit, që sipas traditës vendase simbolizon *shtratin e martesës*, zhvillohet nga nusja dhe dhëndri duke *"çarë kulaçin"*, ku nusja e mban atë me të dy duart, kurse dhëndri vetëm me një dorë. Shtjellimi bëhet në formën e një garimi se kush do të shkëpusë me shumë pjesë nga kulaçi, që arbërisht thuhet: *"Kish shartin më të mirë kush mirr më shumë"*. Të pranishmit përreth manifestojnë me gaz e hare, duke kënduar: *"E sonte na çami kulaçin,/ E një drudhës mos e maçit,/ E ju mungu kini e provoni,/ Pare e çami e pra shomi"*.

Ndër grupet që i bëjnë jehonë ritualit të martesës, do të dallonim *"Vjershëtarët"* nga Maqi, me këngët *"Ngreu ti nuse"* dhe *"Moj ti zemer, moj ti mollë"*, të cilat u kënduan në formë akapelo, nga një grup grash të moshuara.

Atmosferën e *ritit të stolisë*, të përgatitjes të veshjes së nuses, e solli grupi *"Dhëndurit e Arbërit"* nga Hora Arbëreshe. Ndërmjet të tjerash, ai interpretoi një këngë që i bënte jehonë pagëzimit të çiftit. Veprimet mizanskenike, kostumet e bukura arbëreshe dhe përcjellja dinjitoze e orkestrës, ashtu si gjetkë, manifestuan edhe në këtë këngë një bukuri të veçantë. Gjithashtu, grupi *"Shqiponjat"* i Shën Sofisë, me ritet *"Të enjëten e nuses"* dhe *"Të premëten e samarit"*, të cilat u përcollën me veprime lëvizëse, këngë dhe kërcime, pati realizime interesante që u pëlqyen shumë nga të pranishmit.

Nga grupet me folklor burimor kishte edhe shtjellime inskenuese me këngë e kërcime për rite, të tilla si: përgatitja e shtratit, që arbërisht thuhet *"Kur arvojin te shpia e re, ndreqjin gjithësej edhe shtratin"*; ardhja e dhëndrit për herë të parë te shtëpia

e nuses – “kur qaset dhëndërri i lppen çdo, ndëse nusen o skamandilin” (shaminë e nuses). Dhëndri përgjigjet se “do mparë fëmijën, pra nusen e nde fund skamandilin”; apo riti kur “ndrrohen tri herë unazat e kurorat”.

Jehonën e ritualeve të martesës e solli edhe grupi i *Institutit të Bashkuar* nga fshati Frashinetë, me “*Ritin e përgatitjes së vajzës që bëhet nuse*” dhe grupi “*Dielli*” nga Mungresano, me “*Ritin e bërjes nuse*”.

Ritualet e ceremonialit të martesës në festival shkëlqyen më së shumti përmes dasmës së Strigharit, e cila u zhvillua në rrugët dhe sheshet e fshatit, pra në natyrë, ditën e parë të hapjes së Festivalit. Ishte si një mirëseardhje manifestuese për miqtë e shumtë, me qindra e mijëra vetë, që e përcollën atë me kërshtëri dhe emocione të mëdha. Çdo ritual i martesës u paraqit mirë dhe bukur deri aty sa nuk të besohej se ishte një përshtatje riprodhuese, por një dasme e vërtetë. Pjesëmarrësit e shumtë, pothuajse të tërë banorët e fshatit, duke qëndruar në pika te caktuara ose duke ecur nëpër rrugicat dhe shtëpitë karakteristike, me ato veshje të larmishme, kryesisht të grave arbëreshe, sollën një mori ritesh të martesës, si: “*Zënia e brumit*”, “*Marrja e nuses*”, “*Pagëzimi i çiftit në kishë*” e shumë të tjera. Të lëvizurit e pjesëmarrësve përmes pasazhesh me doke e zakone tradicionale arbëreshe, këngët përcjellëse që u kënduan me aq pathos nga gra të moshuara, apo e gjithë ajo orendi shtëpiake me magje, qilima, zjarre, shtretër, sëndukë e të tjera, të cilat u bënë jehonë riteve të martesës, kryesisht “çiftit të porsamartuar”, u kryen me origjinalitet të madh, duke u shkrirë me to organikisht edhe të ftuarit e shumtë, të cilët ngjasonin si krushq dhe dasmorë të vërtetë.

Qe kjo paraqitje mahnitëse, me atmosferën e një përgjithësimi të dasmës së martesës arbëreshe, si edhe, në njëfarë mase, konkurrimi i grupit folklorik të këtij fshati, që Juria e nderoi Strigharin me çmimin më të madh të festivalit, “*Flamurin e Arbëreshëve*”.

Kur kemi në objekt studimi ritualet e martesës, kurrësi nuk mund të anashkalojmë edhe disa këngë e valle që i bënë jehonë atij ceremoniali. Grupet që interpretuan njësi të tilla, qenë: “*Vjershëtarët*” nga Ejanina, me këngën “*Zgjoju nuse*” dhe vallen “*Zëmi vallen*”; “*Vjershëtarët*” nga Shën Mitri, me tri këngë, ku do të veçonim “*Sot me nat dita m’u di*”; “*Shkreptimat*” nga Shën Vasili,

me këngët “*Bashkë detit*” dhe “*O kopile; “Zjarri i zemërës”* nga Ferma, me këngët “*Motra ime*” dhe “*Zgjoju nuse*”; “*Kamastra*” nga Munteçifone, me këngën “*Çe isht i bukur ki dhëndri,/E kjo nusja isht ghian mialt*”; “*Ullania*” nga Shën Benedeti, me vallen “*Jurendina na martohet*”; “*Bashkë me Ylzat*” nga Ferma, me këngën “*Ish një vashëz në ragjeto*” (tarracë) etj.

Në përfundim, do të theksonim se ritualet e martesës u ndoqën me kërshtëri të madhe në *Festivalin e Dytë Evropesdhetar të Këngës dhe Valles Arbëreshe*. Ato shënuan kulme sepse zbuluan vlerat më origjinale dhe estetike të tharmit të folklorit vendës. Artistët popullorë interpretuan me brishtësi, emocionalitet dhe kulturë artistike, duke i fuzionuar këto rituale me karakter të theksuar spektakolar.*

Shënime:

* Festivalin e Dytë të Muzikës dhe Valles Arbëreshe, që u zhvillua në fshatin Strighar të arbëreshëve të Italisë, autori e ndoqi me detyrën e presidentit të *Simpoziumit shkencor dhe të kryetarit të Jurisë*.